



**Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosova
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK- MUNICIPALITY JUNIK**

Kryesuesi i Kuvendit

Nr. 001/33

Datë: 29.12.2010

Bazuar ne nenit 17 paragrafi r) dhe s) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr. 03/L-40, neni 10.1 i Ligjit për bibliotekat Nr.2003/6, Statutit të Komunës Junik, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 29.12.2010, merr këtë:

V E N D I M

(Mbi themelimin e Bibliotekës Komunal të Junikut)

I. Me këtë vendim themelohet Biblioteka Komunale në Junik, e cila do të shërbej për përhapjen e njohurive, kulturës, arsimit, shkencës dhe njeherit do të ofroi shfrytëzuesve mundësi për edukim, informacione dhe zhvillim personal kulturor, profesional, krijues, komunikues dhe qytetarë.

II. Komuna e Junikut me një vendim të veçantë do të përcaktoj lokacionin për ndërtimin e objektit të Bibliotekës Komunale.

Arsyetim

Biblioteka është institucion kulturor, edukues dhe informues, që grumbullon mirëmban dhe ruan koleksionet e veta nga fushat e ndryshme te krijimtarisë dhe veprimtarisë intelektuale, dhe me qellim qe ti bej të njohura dhe t'ua vë në dispozicion shfrytëzuesve për ti lexuar, hulumtuar e studiuar dhe për ti lenë në trashëgimi gjeneratave të ardhshme.

Ky vendim hyn ne fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendi i Komunës dhe i njëjti do te implementohet ne momentin e pare te mundshëm nga ana e ekzekutivit te Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

- Drejtoria për Administratë të përgjithshme

